

Zyra për informim

Komunikatë për media

UNMIK



[www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org)

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

UNMIK/PR/1451

E enjte, 24 nëntor 2005

## **PSSP viziton manastirin e Deçanit dhe kishat në rindërtim e sipër në Prizren**

**PRISHTINË** – PSSP Søren Jessen-Petersen sot vizitoi manastirin e Deçanit me rastin e ditës së Shën Stefanit. Ai theksoi rëndësinë e manastirit të Deçanit si objekt të trashëgimisë kulturore botërore dhe tha: “Ky manastir është trashëgimi i përbashkët e njerëzimit, i të gjithë neve, prandaj, të gjithë ne kemi përgjegjësi ta ruajmë dhe mbrojmë këtë dhe të gjitha objektet e tjera në të ardhmen.”

Pasdite, PSSP vizitoi kishat që janë në rindërtim e sipër në Prizren, përfshirë këtu kishën e Shën Premtes, kishën e Shën Gjergjit dhe kishëzën e Shën Nikollës.

Duke iu drejtuar gazetarëve në kishën e Shën Premtes, PSSP tha, “Mendoj se është shumë me rëndësi që ky rindërtim të vazhdojë tani. Po punojmë bashkë për ta ndërtuar një Kosovë të re në të cilën të gjithë qytetarët do të jenë të sigurtë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, por edhe që secili objekt të jetë i sigurt, pa marrë parasysh bashkësinë të cilës mund t’i takojë.”

PSSP shprehu keqardhje për vjedhjen e kohëve të fundit të mbulesës së plumbtë nga kisha e Shën Premtes, në kohën kur, me Këshillin e Evropës, rindërtimi i të gjitha kishave të shkatërruara ka filluar. Në të njëjtën kohë, ai përgëzoi kryetarin e kuvendit komunal që e dënoi këtë vepër penale dhe policinë për zënien e autorëve menjëherë pas njoftimit për këtë krim.

“Është e qartë se Kosova që dëshiron të hyjë në Evropë është një Kosovë në të cilën këto gjëra më nuk do të ndodhin. Prandaj, është mirë që po shkojmë përpara,” tha PSSP.

Gjersa ishte në këto komuna, PSSP gjithashtu e vizitoi kryetarin e komunës së Deçanit dhe kryetarin e komunës së Prizrenit.